**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11, 13 dhe 58 shkronja f) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 , 16 dhe 61 paragrafi 1.6 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01 - 0050862/18, merr:

# V E N D I M
# PËR LIRIMIN NGA DETYRA E DREJTORIT TË DREJTORISË SË PLANIFIKIMIT URBAN DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

### Neni 1

**z. Leutrim Krasniqi** lirohet nga detyra e Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit në Komunën e Podujevës.

### Neni 2

Lirimi nga detyra e drejtorit sipas nenit 1 të këtij vendimi, bëhet në kërkesë të përmendurit, që ndërlidhet me karrierën e tij profesionale.

### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:
*Të përmendurit*
*Zyrës së Personelit*
*QSHQ/Arkivit*

**Nr.prot.**02-016/01-0077004/24
**Podujevë, datë:** 02.12.2024

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

# KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronjat b) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe neneve 16 dh 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, nxjerr:

## VENDIM

**Neni 1**

Me rastin e lirimit nga funksioni të z. Leutrim Krasniqi ish Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, dorëzim – pranimi i Zyrës përkatëse bëhet nga komisioni ad hoc në këtë përbërje:

| | |
|---|---|
| Mahmut Ajvazi, | kryesues |
| Sabedin Namani, | anëtar |
| Ramadan Plakolli, | anëtar |

**Neni 2**

Procesi i dorëzim-pranimit të zyrës sipas nenit 1 të këtij vendimi bëhet nga ana e Komisionit përmes procesverbalit.

**Neni 3**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Nr.prot.**02-020/04-0077055/24
**Podujevë, datë:** 02.12.2024

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E PODUJEVËS - REPUBLIKA KOSOVO - OPŠTINE PODUJEVO

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronjat b) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.prot.01-020/01-0050862/18, jep këtë :

## A U T O R I Z I M

**I.**

Autorizohet z.Bahri Selimi, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit në Komunën e Podujevës të veproj dhe të nënshkruaj dokumentacionin nga kompetenca dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

**II.**

Autorizimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe i njëjti vlen deri në emërimin e drejtorit të Drejtorisë së cekur, përveç nëse me ndonjë akt tjetër vendoset ndryshe.

*Me këtë njoftohen:*
*I autorizuari*
*Zyra e Personelit*
*QSHQ/Arkivi*

**Nr.Prot.** 02-016/01-0077493/24
**Podujevë, datë:** 04.12.2024

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

# KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronjat b) dhe i) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.9, të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafët 3.1 dhe 3.2 të Rregullores Komunale për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot. 01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0017955/24 të datës 14.03.2024, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0063865/24, të datës 20.09.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione merr;

## VENDIM
## PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PERSONAVE ME GJENDJE TË RËNDË SHËNDETËSORE DHE SOCIALE

**Neni 1**

Me këtë vendim lejohet dhënia e ndihmës financiare në shumë të përgjithshme prej 14,550.oo€, ndihmë për gjashtëdhjetë (70) persona me gjendje të rëndë shëndetësore dhe ekonomike -sociale për muajt tetor- nëntor, 2024, sipas shumave individuale të paraqitura në listën e rekomanduar nga komisioni përkatës.

**Neni 2**

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

**Neni 3**

Shuma e mjeteve individuale sipas listës bashkangjitur këtij vendimi nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022.

**Neni 4**

Lista e përfituesve të ndihmës financiare është pjesë përbërëse e Vendimit.

**Neni 5**

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

**Neni 6**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Nr.prot** 02-400/01-0077604/24
**Podujevë, datë** 04.12.2024

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L- 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 27 paragrafi 1.6, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0017955/24 datë 14.03.2024 i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0063865/24, të datës 20.09.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot.09-615/03-0074766/24, të datës 19.11.2024, të proceduar nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit sipas kërkesës nr.prot.02-400/04-0076532/24, të datës 29.11.2024, merr:

## V E N D I M
## PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

**Neni 1**

[redacted] nga Podujeva për realizimin e projektit kulturor Stand Up Comedy për festat e fund vitit, mbështetet me mjete financiare në shumë 1,500.oo€.

**Neni 2**

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e z.Adnan Blaku i cili në emër të organizatorëve obligohet të sjell raport të detajuar në Drejtorinë përkatëse lidhur me gjitha shpenzimet e këtij aktiviteti.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

**Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*
*Drejtorive përkatëse.*
*QSHQ/Arkivit.*
[redacted] *(njoftohet përmes DKRS-së).*

**Nr.prot**02-400/01-0078281/24
**Podujevë, datë,**09. 12. 2024

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

# KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L- 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 26 paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 dhe 3.2 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0017955/24 datë 14.03.2024 i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0063865/24, të datës 20.09.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot. 06-400/04-0076829/24, të datës 02.12.2024, merr:

## V E N D I M
## PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

**Neni 1**

[redacted], nga fshati Batllavë Komuna e Podujevës për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve mjekësore, i jepet ndihmë financiare në shumë 500.oo€.

**Neni 2**

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurit.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

**Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*
*Drejtorisë përkatëse.*
*QSHQ/Arkivit.*
[redacted] *(njoftohet përmes DSHMS-së).*

**Nr.prot** 02-400/01-0078283/24
**Podujevë, datë,** 09. 12. 2024

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

KOMUNA E PODUJEVËS - KRYETARI I KOMUNËS - REPUBLIKA E KOSOVËS - OPŠTINA PODUJEVO - PREDSEDNIK OPŠTINE - PODUJEVË/O

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L- 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 24 paragrafi 1 të Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0017955/24 datë 14.03.2024 i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0063865/24, të datës 20.09.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot.12-320/01-0076200/24, të datës 26.11.2024, të proceduar nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural sipas kërkesës nr.prot.02-400/04-0077516/24, të datës 04.12.2024, merr:

## V E N D I M
## PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

**Neni 1**

[illegible] fermer nga fshati Dobërdol, Komuna e Podujevës, mbështetet me mjete financiare në shumë 2000.oo€, me qëllim të kompensimit dhe rimëkëmbjes së ekonomisë së tij familjare nga dëmi i shkaktuar si pasojë e sulmit të ujqërve në stallën e deleve (mbytjes së 23 krerëve dele, 43 krerë dele të plagosura dhe 14 krerë dele të zhdukura nga ujqërit).

**Neni 2**

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë deh Zhvillimit Rural dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurit.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

**Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*
*Drejtorive përkatëse*
*OSHQ/Arkivit.*
[illegible] *(njoftohet përmes DBPZHR-së)*

**Nr.prot** 02-400/01-0078287/24
**Podujevë, datë,** 09.12.2024

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronjat b) dhe i) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.9, të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafët 3.1 dhe 3.2 të Rregullores Komunale për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot. 01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0017955/24 të datës 14.03.2024, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0063865/24, të datës 20.09.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione merr;

## VENDIM
## PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PERSONAVE ME GJENDJE TË RËNDË SHËNDETËSORE DHE SOCIALE

### Neni 1

Me këtë vendim lejohet dhënia e ndihmës financiare në shumë të përgjithshme prej 6,000.oo€, ndihmë për tridhjetetre (33) persona me gjendje të rëndë shëndetësore dhe ekonomike -sociale për muajt tetor- nëntor- dhjetor, 2024, sipas shumave individuale të paraqitura në listën e rekomanduar nga komisioni përkatës.

### Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

### Neni 3

Shuma e mjeteve individuale sipas listës bashkangjitur këtij vendimi nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022.

### Neni 4

Lista e përfituesve të ndihmës financiare është pjesë përbërëse e Vendimit.

### Neni 5

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

### Neni 6

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Nr.prot** 02-400/01-0078333/24
**Podujevë, datë** 09.12.2024

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 44 të Ligjit nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, neneve 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01/0050862/18, në kërkesë të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit datë 05.12.2024, nxjerr;

# V E N D I M

### Neni 1

Për vlerësimin dhe përzgjedhjen e punimeve të krijuesve në aktivitetin letrar ***Takimet e Kulturës "Kadri Kadriu"-2024,*** në fushat; ***Poezi, Ese dhe Tregim i Shkurtër***, sipas konkursit letrar të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, publikuar më 21 nëntor 2024, formohet komisioni në këtë përbërje:

- **Isuf Sadriu**, *Profesor i gjuhës dhe letërsisë shqipe,* kryesues
- **Fadil Halimi**, *Profesor i letërsisë dhe gjuhës shqipe,* anëtar
- **Vjollca Breznica**, *Profesoreshë e gjuhës dhe letërsisë shqipe,* anëtare

### Neni 2

Komisioni sipas nenit 1 të këtij vendimi, bën vlerësimin dhe përzgjedhjen e punimeve letrare në fushat sipas këtij vendimi në përputhje me kriteret e konkursit përkatës, si dhe përgatit informatë në formë të shkruar të cilën i'a paraqet Zyrës së Kryetarit të Komunës, përmes Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

### Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit - DKRS.

### Neni 4

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet;*
*Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit-DKRS*
*Anëtarëve të komisionit, përmes DKRS-së*
*QSHQ/Arkivit*

**Nr.Prot:** 02-020/04-0078398/24
**Podujevë, datë:** 09.12.2024

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

**KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat f) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr.01-1/298-10, në zbatim të Marrëveshjes nr.prot.02-016/01-0073448/23 të datës 06.10.2023, Lidhur në mes Komunës së Podujevës dhe Shoqatës Bamirëse "Jetimat e Ballkanit" për ndërtimin e "Shtëpisë për Qëndrim Ditor për të Moshuar Kuzhinë Humanitare dhe Bujtinë", në Podujevë, merr:

**V E N D I M**

**I**

**z.Mahmut Ajvazi**, zyrtar në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, caktohet menaxher nga Komuna e Podujevës, për mbikëqyrjen e punimeve në kuadër të projektit për ndërtimin e Objektit "Shtëpisë për Qëndrim Ditor për të Moshuar Kuzhinë Humanitare dhe Bujtinë" në Podujevë, i cili realizohet sipas Marrëveshjes nr.prot.02-016/01-0073448/23 të datës 06.10.2023 të lidhur nga Komuna e Podujevës dhe Shoqata Bamirëse "Jetimat e Ballkanit"

**II**

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**III**

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi nr.prot.02-020/05-0016415/24 i datës 06 mars 2024

*I'u dërgohet:*
*Të caktuarit,*
*Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS*
*Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit*
*Shoqatës "Jetimat e Ballkanit" për njoftim - përmes DSHMS*
*QSHQ / Arkivit*
*Zyrës së Personelit*

**Nr.Prot:** 02-020/05-0078598/24
**Podujevë, datë,** 10.12.2024

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - KOMUNA E PODUJEVËS - OPŠTINA PODUJEVO

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L- 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 15 paragrafi 1.6 të Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0054227/22 të datës 04.07.2022, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0008957/23 të datës 01.02.2023, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot 05-615/03-0072433/24, të datës 05.11.2024, merr:

## V E N D I M
## PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

**Neni 1**

[illegible], nga fshati Letanc, Komuna e Podujevës, për mbulimin e shpenzimeve të djalit të saj [illegible] i cili do të përfaqësoj Kosovën në garat e lëndës së Matematikës në Dubai, mbështetet me mjete financiare në shumë 200.oo€.

**Neni 2**

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Arsimit dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurës.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

**Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*
*Drejtorive përkatëse.*
*OSHO/Arkivit.*
[illegible] *i (njoftohet përmes DKA-së).*

**Nr.prot** 02-400/01-0078617/24
**Podujevë, datë,** 11.12.2024

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, merr:

## V E N D I M

**Neni 1**

**znj.Florie Mani**, inxhiniere në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, krahas punëve dhe detyrave nga pozita që mban autorizohet për kryerjen punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe përgjegjësitë e inspektorit të ndërtimit në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Podujevës.

**Neni 2**

Autorizimi sipas këtij vendimi lëshohet me qëllim të mbulimit të pozitës së inspektorit të ndërtimit dhe i njëjti vlen deri në rekrutimin e zyrtarit/es në pozitën e cekur konform rregullativës ligjore, apo deri në një akt tjetër administrativ, por jo më gjatë se tre muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

**Neni 3**

E përmendura deponon nënshkrimin për vulosjen e dokumentacionit nga fushë veprimtaria e pozitës së cekur.

*Nënshkrimi i të autorizuarës*_______________

**Neni 4**

Për zbatimin e vendimit kujdesen Drejtoria e Inspeksionit, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit si dhe Zyra e Personelit.

**Neni 5**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*Me këtë vendim njoftohen:*
*E Autorizuara*
*Drejtoria e Inspeksionit*
*Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit*
*Zyra e Personelit*
*QSHQ/Arkiva*

**Nr.Prot.** 02-016/01-0078630/24
**Podujevë, datë,** 11.12.2024

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, merr:

## V E N D I M

**Neni 1**

**z. Musli Kutleshi**, zyrtar i lartë për ndërtimtari në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, krahas punëve dhe detyrave nga pozita që mban autorizohet për kryerjen punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe përgjegjësitë e inspektorit të ndërtimit në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Podujevës.

**Neni 2**

Autorizimi sipas këtij vendimi lëshohet me qëllim të mbulimit të pozitës së inspektorit të ndërtimit dhe i njëjti vlen deri në rekrutimin e zyrtarit/es në pozitën e cekur konform rregullativës ligjore, apo deri në një akt tjetër administrativ, por jo më gjatë se tre muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

**Neni 3**

I përmenduri deponon nënshkrimin për vulosjen e dokumentacionit nga fushë veprimtaria e pozitës së cekur.

*Nënshkrimi i të autorizuarit*________________

**Neni 4**

Për zbatimin e vendimit kujdesen Drejtoria e Inspeksionit, Drejtoria Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit si dhe Zyra e Personelit.

**Neni 5**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*Me këtë vendim njoftohen:*
*I Autorizuari*
*Drejtoria e Inspeksionit*
*Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit*
*Zyra e Personelit*
*QSHQ/Arkiva*

**Nr.prot.** 02-016/01-0078629/24
**Podujevë, datë:** 11.12.2024

**Kryetari i Komunës**
**Shpëjtim Bulliqi**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Mbështetur në nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr 03/L-04, Udhëzimin Administrativ MAPL nr. 2008/01 për përdorimin e automjeteve zyrtare në Komuna, dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, jep:

# AUTORIZIM

Autorizohen z. Abedin Zeka, i lindur më [redacted] në Dortmund, me vendbanim në Podujevë, numri personal [redacted] nr. i letërnjoftimit [redacted] lëshuar në Prishtinë dhe z.Agron Fusha i lindur më [redacted] në Podujevë me nr.personal [redacted], nr i letërnjoftimi i [redacted] që gjatë orarit të punës dhe jashtë orarit të rregullt të punës, në territorin e Kosovës dhe jashtë shtetit të Kosovës, të vozisë automjetin zyrtar:

Marka dhe Tipi Audi B8 A4 TDI 2.7
Numri i shasisë WAUZZZ8K4AN001774
Ngjyra e Zezë
Numri i targave 01-580-ZF
Viti i prodhimit 2009

Autorizimi jepet në afat të pacaktuar, përkatësisht deri në një akt tjetër administrativ.

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

**Nr.prot.** 02-016/01-0078791/24
**Podujevë, datë:** 11.12.2024

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L- 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 26 paragrafi 3, nën paragrafët 3.1 dhe 3.2, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0017955/24 datë 14.03.2024 i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0063865/24, të datës 20.09.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot. 06-400/04-0078368/24, të datës 09.12.2024, merr:

## V E N D I M
## PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

**Neni 1**

[redacted] nga Podujeva për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve mjekësore i jepet ndihmë financiare në shumë 1000.oo€.

**Neni 2**

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurës.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

**Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*
*Drejtorive përkatëse.*
*QSHQ/Arkivit.*
[redacted]*i (njoftohet përmes DSHMS-së).*

**Nr.prot** 02-400/01-0078792/24
**Podujevë, datë,** 11/12/2024

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

**KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040 dhe nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29.06.2018, jep këtë:

**AUTORIZIM**

z.Liridon Gashi, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit në Komunën e Podujevës autorizohet të deponojë nënshkrimin në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë, për vulosjen e dokumentacionit që ka të bëjë me kompetencat dhe fushë veprimtarinë e Drejtorisë së cekur.

Nënshkrimi i të autorizuarit________________________

*U dërgohet:*
*Të autorizuarit*
*Zyrës së Personelit*
*QSHQ/arkivit*

**Nr. prot.**02-016/01-0079060/24
**Podujevë, datë,** 12.12.2024

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 58 shkronja f) dhe nenin 62.2 të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, nenet 16, 61 paragrafi 1.6 dhe nenin 64 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, merr,

**V E N D I M**
**PËR EMËRIMIN E DREJTORIT TË DREJTRISË SË PLANIFIKIMIT URBAN DHE MBROJTJES SË MJEDISIT NË KOMUNËN E PODUJEVËS**

**Neni 1**

**z.Liridon Gashi**, nga Prishtina, me profesion Arkitekt, emërohet:

- **Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit**

**Neni 2**

I përmenduri, në funksionin e cekur emërohet në kohëzgjatje të mandatit të Kryetarit të Komunës së Podujevës, përveç nëse Kryetari i Komunës me vendim të veçantë vendos ndryshe.

**Neni 3**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*
*Të emëruarit*
*Zyrës së personelit*
*QSHQ/arkivit*

**Nr.Prot.** 02-101/03-0078853/24
**Podujevë, datë,** 12.12.2024

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# KRYETARI I KOMUNËS

Mbështetur në nenin 58 shkronja b) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040 dhe nenin 61 parag. 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës, nr. 01-020/01-0050862/18, jep këtë:

## AUTORIZIM

Autorizohet z.Sevdaim Maliqi, inspektor i shërbimeve publike në Drejtorinë e Inspeksionit të deponoj nënshkrimin në Qendrën e shërbimit për qytetarë për vulosje të dokumentacionit nga fushëveprimi lëmisë përkatëse.

**Nënshkrimi i të autorizuarit** Maliqi

**Nr. prot.** 02-016/01-0079778/24
**Podujevë, datë:** 17.12.2024

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 44 të Ligjit nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, neneve 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01/0050862/18, në Kërkesë të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit me nr.prot.02-020/04-0079866/24 të datës 18.12.2024, nxjerr këtë;

## V E N D I M
## PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR PËRZGJEDHJEN E SPORTISTËVE TË DALLUAR PËR VITIN 2024 NË KOMUNËN E PODUJEVËS

**Neni 1**

Për përzgjedhjen e sportistëve të dalluar të vitit 2024 në Komunën e Podujevës, formohet komisioni në këtë përbërje:

1. **Vehbi Kastrati,** kryesues
2. **Ismail Krasniqi**, anëtar
3. **Feride Kastrati**, anëtare
4. **Vlora Hajdini**, anëtare
5. **Kadri Idrizi,** anëtar

**Neni 2**

Komisioni bënë vlerësimin e propozimeve / nominimeve të Klubeve Sportive dhe në bazë të sukseseve dhe rezultateve të arritura në gara vendore dhe ndërkombëtare, bënë përzgjedhjen e sportistëve të dalluar për vitin 2024 në Komunën e Podujevës.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

**Neni 4**

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

*Vendimi i'u dërgohet:*
*Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit-DKRS*
*Anëtarëve të komisionit, përmes DKRS-së*
*QSHQ/Arkivit*

**Nr.Prot.** 02-020/04-0080055/24
**Podujevë, datë:** 18.12.2024

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenet 16 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, dhe konform Ftesës Publike nr. prot. 15-300/01-0079266/24, të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik-DPZHE, të publikuar më 16.12.2024, nxjerr:

## VENDIM

**Neni 1**

Për shqyrtimin e aplikacioneve për ndarjen e shtëpizave të drurit sipas Ftesës Publike të DPZHE për projektin **"Ditët e Fund Vitit 2024"** që ka për qëllim rritjen e aktiviteteve argëtuese dhe promovuese me rastin e festave të fund vitit dhe fluksit të ardhjes së mërgimtarëve, ku do të ofrohen shërbime të gastronomisë në "Sheshin e Dëshmorëve" në Podujevë, ngritet komisioni, në përbërje:

Rilind Babatinca, kryesues
Shkurte Musa, anëtare
Blerta Ajvazi , anëtare

**Neni 2**

Komisioni, bën shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve si dhe përzgjedhjen e aplikantëve / bizneseve që do të ushtrojnë veprimtaritë e tyre në shtëpizat e drurit në "Sheshin e Dëshmorëve" sipas projektit të publikuar me Ftesën Publike.

**Neni 3**

Komisioni për punën e kryer, në formë të shkruar e informon Kryetarin e Komunës, përmes Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik.

**Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:
*Anëtarëve të Komisionit*
*Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik*
*QSHQ/Arkivit*

**Nr. prot.** 02-020/04-0080056/24
**Podujevë, datë:** 18.12.2024

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L- 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 26 paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0017955/24 datë 14.03.2024 i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0063865/24, të datës 20.09.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot.06-400/04-0080069/24, të datës 19.12.2024, merr:

**V E N D I M**
**PËR PËRKRAHJE FINANCIARE**

**Neni 1**

[redacted] nga fshati Bradash Komuna e Podujevës për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore të vajzës së saj [redacted] dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve mjekësore, i jepet ndihmë financiare në shumë 1000.oo€.

**Neni 2**

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurit.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

**Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*
*Drejtorisë përkatëse.*
*OSHQ/Arkivit.*
[redacted] *(njoftohet përmes DSHMS-së).*

**Nr.prot** 02-400/01-0080235/24
**Podujevë, datë,** 19.12.2024

**Kryetari i Komunës**
**Shpëjtim Bulliqi**